




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
 Republika Kosova- Opstine Suvareka
 Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.402/350-39540 datë: 30.09.2020
REFERENC-Ë:	07Nr.350-39540 datë: 25.08.2020
PËR/TO:	Elez Sejdi Haxhiolli, rruga Kadri Kokollari” - Suharekë
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: Sanie KUQI
	Punoi: Sedat Bytyçi, inxh.dip.ndërt.
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-39540 datë: 25.08.2020 nga Elez Sejdi Haxhiolli nga Suhareka, për Leje Ndërtimore për objektin shtëpi individuale, me etazhitet P+1, në parcelën kadastrale 01157-50, me numër referues të certifikatës 952-02/2020 datë 08.07.2020, pronë e Elez Sejdi Haxhiolli. Andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 30.09.2020

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr. 402/350-39540

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, neni 2, pika 2.2 të vendimit për aprovim të taksave administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit për kategorinë e I-rë dhe të II-të, lejes së rrënimit dhe tarifën rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës të Kuvendit të Komunës Suharekë: 01-Nr-016-21653, të datës: 29.03.2019, Rregullore për tarifa, ngarkesa dhe gjoha nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale, 01-12102, datë 01.12.2015, neni 8.14, pika 14.1, Vendim mbi ndryshimin e pjesshëm për PrrU 01Nr.16-423 datë 26.01.2011, si dhe Planit Rregullues Urban Slloxha Suharekë, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Elez Sejdi Haxhiolli-Suharekë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë :

AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	ELEZ SEJDI HAXHIOLLI	Nr. Personal	
Adresa:	Rr." Kadri Kokollari", Suharekë	Telefoni:	
Email :	/	Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore: 07Nr.350-39540, datë: 25.08.2020

Emri i Projektit:	OBJEKT- SHITËPI INDIVIDUALE		
Emri i Projektuesit:	"ENGINEERING" sh.p.k, Suharekë		
Adresa:	Rr."Nënë Tereza" p.n , Suharekë		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI			
Adresa: Rr." Kadri Kokollari ", SUHAREKË			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	Koordinatat e objektit-Shënimi(Piketimi):	
Sipas çertifikatës me nr. të lëndes : 2026/2020, datë 08.07.2020, Zona Kadastrale- Suharekë	01157-50	1 Y= 7486438.889; X=4691351.644 2 Y= 7486448.287; X=4691348.225 3 Y= 7486444.868; X=4691338.828 4 Y= 7486439.464; X=4691340.794 5 Y= 7486439.96; X=4691342.156 6 Y= 7486435.966; X=4691349.273	

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt-shtëpi individuale			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria I			
Gabariti	Sipërfaqe bruto e objektit 210.20m ²	Katshmëria:	(P+1)
Vija rregullative	Nga aksi i rrugës "Kadri Kokollari" 6.0m'	Vija ndërtimore	Sipas Njoftimit rreth Kushteve ndërtimore: 07Nr.274/350-26464; dt.12.08.2020, 4m nga V.RR rrugës "Kadri Kokollari" -6m'

Përshkrimi i lejës ndërtimore

Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore *Elez Sejdi Haxhiolli nga Suhareka* i lejohet ndërtimi i objektit shtëpi individuale me etazhitet P+1.

Lokacioni i objektit është në kuadër të PRRU-së Silloxa Suharekë, Vendim mbi ndryshimin e pjesshëm për PrrU 01Nr.16-423 datë 26.01.2011, sipas gjendjes së planifikuar, në parcelën kadastrale 01157-50, dhe sipas hartimit të projektit nga byroja projektuese: "ENGINEERING" sh.p.k, Suharekë.

Objekti ka karakter të përhershëm me katëshmëri (P+1). Ndërtimi i objektit të bëhet konform njoftimit rreth Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.274/350-26464, datë: 12.08.2020.

Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe bruto : 210.20m².

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat

rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;

- Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar s y e t i m

Aplikuesi **Elez Sejdi Haxhiolli** nga **Suhareka**, përmes kërkesës 07Nr.350-39540, të datës: 25.08.2020, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit shtëpi individuale, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim rreth Kushteve Ndërtimore 07Nr.274/350-26464, datë: 12.08.2020 (kopje)
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.132/20, datës: 14.08.2020, lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Dëshmi për pagesën e taksës administrative për Leje Ndërtimore sipas njoftimit 07Nr.367/350-39540, datë: 18.09.2020, në shumë prej: 85.75€ (duke e zbritur objektin e vjetër me leje), e paguar në F.J.B Vllesa-co Suharekë, datë: 18.09.2020, sipas faturës komunale nr.0000581, datë: 18.09.2020.
- Vërtetim nga K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A. Prizren Nr.55, Njësia-Suharekë datë: 17.08.2020.
- Aktvendim-Pëlqim se janë të plotësuar kushtet dhe kriteret e komunikacion rrugor – nga

Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09 Nr.537, datë: 18.08.2020.

- Pëlqim me kushte për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.968, datë: 24.08.2020.
- Incizim gjeodezik dhe Koordinatat e vendosjes së objektit të propozuar.
- Leje Ndërtimore e objektit të vjetër, 04.Nr.351-375 Suharekë, më 05.12.1978.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit Identifikues


Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform Planit Rregullues Urban Silloxha Suharekë, Vendimit mbi ndryshimin e pjesshëm për PrrU 01Nr.16-423 datë 26.01.2011 ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MEA në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.402/350-39540 datë: 30.09.2020

Vendimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës;
Inspektoratit të Komunës;
Dosjes së DUP-së



Drejtori i Drejtorisë:
Sanie KUQI

[Signature]